

Keshilli i Arbitrazhit Sportiv.

KAS

I. Krijimi:

Keshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS), eshte krijuar si gjykate arbitrazhi e shkalles se pare me ligjin nr.9816 date 22.10.2007 “Per Sportin” i cili me ndryshimet e bera ne nenin 22 te ligjit te meparshem per sportin ka hequr kompetencen e gjykates se zakonshme duke e zevendesuar kete me gjykatën e arbitrazhit sportiv.

Arben Rakipi, 16 Maj 2011

II. Kuadri ligjor dhe nenligjor:

- Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është krijuar dhe funksion në bazë të:
- Kartës Olimpike, kreu V neni 74;
- Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, neni 400 e vijues;
- Ligjit nr. 9376, datë 21/04/2005 “Për sportin” kreu V, nenet 21 dhe 22;
- Statutit të KOKSH;
- Statuteve dhe Rregulloreve të anëtarëve të KOKSH;
- Rregullores se Keshillit te Arbitrazhit Sportiv, miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e Komitetit Olimpik Shqiptar ne date 31.05.2008.
- Statuteve dhe Rregulloreve të Organizmave Sportive Ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar;

III. Statusi:

- KAS eshte organ arbitrazhi sportiv, pra eshte gjykate arbitrazhi qe gjykon pergjithesisht ne shkalle te pare dhe zgjidh konfliktet / mosmarreshjet ne sport.
- KAS eshte institucion i perhershem arbitrazhi. Ai nuk ngrihet per zgjidhjen e nje konflikti te caktuar ne baze te marreshjes konkrete te paleve, por funksion perhere si organ arbitrazhi per zgjidhjen e te gjitha konflikteve Neni 401/1 i K.Pr.Civile dhe neni 22 i ligjit “Per sportin”.

Kompetenca lendore e KAS

- Cdo anetar, ne rast se vendimet e organeve drejtuese te organizatave sportive bien ne kundersizim me ligjin dhe me statutin e tyre;
- KAS eshte krijuar dhe funksionon si organ keshillimi dhe arbitrazhi sportiv ;
- KAS eshte kompetent per gjykimin ne shkalle te pare te mosmarreshjeve; (me poshte)
- Vendimet e organeve të FSHGJ nuk mund të jenë objekt ankimi dhe gjykimi në gjykatën civile. Kundër këtyre vendimeve mund të apeloher në Këshillin e Arbitrazhit Sportiv;
- Cdo mosmarreshje e lindur nga apo ne lidhje me Lojerat Olimpikë duhet t'i nenshtrohet ekskluzivisht Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv ;
- Gjykata e Arbitrazhit Sportiv CAS Lausanne, Zvicër eshte kompetente si shkalle e fundit (vendimet e te ciles jane te formes se prere) per ankimet ndaj vendimeve te gjykatave sportive te federative (

IV. Formimi dhe perberja:

- Te gjitha rregullat per perberjen e KAS-it dhe organizimin e tij, numrin e arbitrave, kriteret e zgjedhjes se tyre, mandatin, zevendesimin dhe shkarkimin e tyre, percaktohen ne nenet 3, 4, 5, 6, 7, dhe 9 te rregullores se KAS. Per cka nuk parashikohet shprehimisht ne kete rregullore aplikohen dispozitat e K.Pr.Civile, nenet 407-413.

V. Funksionimi dhe parimet:

- Parimet themelore te procesit gjyqesor ;
- Parimet e pavarësisë, konfidencialitetit dhe paanshmërisë.

Ne shkalle te pare

- Sipas nenit 8 te rregullores se KAS, ky eshte kompetent per shqyrtimin ne shkalle te pare te ketyre mosmarreshjeve:
- Mosmarreshjet me karakter tregtar ne lidhje me:
- Ekzekutimin e kontratave dhe akteve të tjera juridike;
- Sponsorizimin e aktiviteteve të ndryshme;
- Shitjen e të drejtës televizive;
- Organizimin e aktiviteteve sportive;
- Transferimin e lojtarëve;
- Kontratat e punës mes klubeve sportive dhe të punësuarve qofshin këta sportistë apo staf teknik;
- Mosmarrëshjet midis sportistëve ose stafit teknik dhe klubeve sportive.
- Mosmarreshjet per pergjegjesite civile ne lidhje me:
- Aksidentimin e një sportisti gjatë një aktiviteti sportiv.
- Dëmtimin e pronës së klubeve sportive si pasojë e veprimeve të dhunshme të kryera gjatë ose pas aktivitetit sportiv, por që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë aktivitet.
- Dëmtimin e imazhit të klubeve sportive si pasojë e veprimeve apo deklarimeve të sportistëve apo stafit teknik.

Te tjera

- KAS ka detyra konkrete dhe ushtron kompetencat si vijon:
- Zgjidh ankimet e cdo anetari ndaj vendimeve te organeve drejtuese te organizatave sportive kur keto bien ne kundershtim me ligjin dhe me statutin e tyre.
-
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit nëpërmjet arbitrazhit si dhe dhënia e opinionëve dhe këshillave në lidhje me çdo çështje të së drejtës që rregullon sportin apo zhvillimin e sportit dhe çdo aktivitet tjetër të lidhur me sportin.
-
- Cdo pretendim pasuror ose nje kerkese qe rrjedh nga nje marredhenie pasurore, mund te jete objekt i nje gjykimi te arbitrazhit.
-
- Zgjidh ankimet ndaj vendimeve te organeve te Federates Neni 22 i ligjit per Sportin.
- Rregullore e Keshillit te Arbitrazhit Sportiv, miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e Komitetit Olimpik Shqiptar ne date 31.05.2008, neni 2.
- Neni 402/1 I K.Pr.Civile.

VII. Procedura e gjykimit:

- Procedura e arbitrazhit, rregullohet ne nenet 10-30 te rregullores se KAS.

VIII. Vendimi i KAS:

- Vendimi i KAS eshte vendim i nje gjykate arbitrazhi dhe si i tille i nenshtrohet aplikimit te dispozitave procedurale, neneve 428-433 te Kodit te Procedures Civile.

IX. Ankimi ndaj vendimit te KAS:

- Vendimi i KAS, si gjykate arbitrazhi mund te ankimohe vetem ne rastet e percaktuara shprehimisht ne nenin 434 te K.Pr.Civile dhe jo ne cdo rast.
- Afati i ankimit eshte 30 dite duke filluar ky afat nga dita qe eshte shpallur vendimi. Mungesa e paleve ne shpalljen e vendimit nuk e ngarkon gjykatën me detyrimin per njoftimin e vendimit.
- Gjykata e Apelit shqyrton ankimin sipas rregullave te caktuara ne kete Kod. Kur gjykata e apelit prish ose ndryshon vendimin e gjykates se arbitrazhit, ajo vendos per themelin e mosmarreveshjes ne kufijte e misionit te caktuar gjykates se arbitrazhit.
- Vendimi i Gjykates se Apelit eshte vendim i formes se prere, kunder tij nuk lejohet rekurs ne Gjykatën e Larte.
- Vendimi i KAS mund të ankimohe brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja dijani, në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Luzanë, Zvicër, vendimi i së cilës është përfundimtar.
-

X. Procedura gjate fazes se ekzekutimit te vendimit:

- Per proceduren qe do te ndiqet ne fazen e ekzekutimit te vendimit te KAS, do te zbatohen te gjitha rregullat procedurale civile te parashikuara ne pjesen e katert “Ekzekutimi i detyrueshem” te Kodit te Procedures Civile. Vendimi i KAS perben titull ekzekutiv sipas nenit 510/ç.